



Periodik mujor Nr. 176 Janar 2024

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**Takim i Anëtarëve të Platformës së
Partneritetit për Integrimin Evropian
për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”**

Tregu i Sigurimeve, Janar – Dhjetor 2023

Tregu me Pakicë i Titujve të Qeverisë, Janar – Dhjetor 2023

VËSHTRIM MBI TREGJET

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

6 – 7

8-10

Takim i Anëtarëve të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi me date 17 janar takim me anëtarët e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) në kuadër të negociatave për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”. Pjesëmarrës në takim ishin institucionet anëtare të PPIE, përfaqësues nga shoqatat e siguruesve, të fondeve të investimit dhe pensionit privat, shoqata e Bankave, shoqata e aktuarëve, përfaqësues nga Këshilli i Investimeve, akademikë, ekspertë të tregjeve financiare, si dhe përfaqësues të medias.

Duke hapur këtë takim Zj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoare Ekzekutive e Autoritetit, në cilësinë e negociatorit të Kapitullit 9 “Shërbimet financiare”, prezantoi nismat ligjore, pjesë e Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030 dhe të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2024-2030. Në takim u diskutua mbi progresin e arritur në Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, i cili e vendos Shqipërinë përpara gjithë vendeve të tjera të rajonit në këtë fushë, referuar gjetjeve të Progres Raportit 2023, të Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Anëtarët e Platformës së Partneritetit vlerësuan organizimin e tryezës së diskutimit dhe këshillimit, në kuadër të procesit të integritimit evropian. Ata shprehën gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit dhe kontributin e tyre, me qëllim avancimin drejt përafrimit të mëtejshëm të akteve ligjore dhe rregullatore, me *acquis* të Bashkimit Evropian.



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar–Dhjetor 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2023 kapën vlerën 22,897 milionë lekë, ose 8.86% më shumë se në vitin 2022. Gjatë vitit 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,466,080 me një rritje prej 10.63% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.82% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës realizuan 8.12% dhe risigurimi 0.06%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.94% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.06% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,959 milionë lekë, ose 1.89% më shumë se në vitin 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për vitin 2023 kapën vlerën 4,793 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 7.81% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar–Dhjetor 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë vitit 2023 arritën rreth 13,980 milionë lekë, ose 6.94% më shumë se në vitin 2022

Ecuria e Tregut me Pakicë të Titujve të Qeverisë, 2023

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për vitin 2023, u dominua në masën 67.59% nga transaksione në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 32.41% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 85.21% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të titujve të Qeverisë për vitin 2023, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 42.58% dhe 47.35% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2023 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.31% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Trasaksionet B dhe C


Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë vitit 2023, ka pasur një ulje prej 1,418 milionë lekë ose 23.05% krahasuar me vitin 2022. Numri i transaksioneve i llojit B është rritur në masën 11.36%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë vitit 2023, ka pasur një rritje prej 32.79 milionë lekë ose 1.05%, ndërkohë pati dhe një rritje në numrin e transaksioneve në masën 39.87%, krahasuar me vitin 2022.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 1,385 milionë lekë, krahasuar me vitin 2022.

Tregu i titujve të Qeverisë, viti 2023

(Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë, për vitin 2023 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.31% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


Botohet studimi vjetor : “Një vështrim mbi pensionet 2023”

Tregues nga OECD dhe G20



Pensions at a Glance 2023

OECD AND G20 INDICATORS



Edicioni i vitit 2023 “ Një vështrim mbi pensionet” thekson reformat e pensioneve të ndërmarra nga vendet e OECD gjatë dy viteve të fundit. Ai përshkruan rregullat ekzistuese dhe karakterizon tendencat e fundit të politikave lidhur me pensionet.

Ky botim përditëson gjithashtu informacionin mbi tiparet kryesore të dhënies së pensioneve në vendet e OECD dhe G20 dhe ofron parashikime të të ardhurave nga pensioni për punëtorët e sotëm. Ai ofron mjaft tregues të tjerë të ndërtimit të sistemeve të pensioneve.



Informacioni i plotë mbi botimin e OECD gjendet në linkun:

<https://www.oecd.org/newsroom/improving-opportunities-and-working-conditions-for-older-workers-can-bolster-pension-system-sustainability-and-address-labour-market-shortages.htm>



Përmirësimi i mundësive dhe i kushteve të punës për punëtorët e moshuar mund të forcojë qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve dhe të adresojë mungesat e tregut të punës

Për vendet e OECD, përqindja e popullsisë mbi moshën 65 vjeç, parashikohet të arrijë në vitin 2050 në 27% të numrit total të saj. Kështu, promovimi i punësimit të punëtorëve të moshuar do të jetë kyç për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemeve të pensioneve dhe për të adresuar mungesat në tregun e punës.

“Një vështrim mbi pensionet, 2023” tregon për politikën e vendeve të OECD-së të cilat kanë kombinuar veprimet për të rritur moshën ligjore të daljes në pension, për të zvogëluar daljet e parakohshme në pension dhe për të ofruar stimuj për të punuar më gjatë dhe për të përmirësuar aftësitë në mënyrë që të nxisin të punësuarin, lëvizshmërinë e punës dhe ofertën e punës për punonjësit e moshuar.

Mosha normale e pensionit është vendosur të rritet në 23 nga 38 vendet e OECD-së, duke arritur një mesatare prej 66.3 vjet për burrat dhe 65.8 vjet për grate, që fillojnë karrierën e tyre sot. Në Danimarkë, Estoni, Itali, Holandë dhe Suedi, mosha normale e daljes në pension do të rritet në 70 vjet ose më shumë, nëse studimet për jetëgjatësinë do të rezultojnë të sakta dhe do të materializohen në realitet.

Përmirësimi i mundësive dhe kushteve të punës për punëtorët e moshuar mund të forcojë qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve dhe të adresojë mungesat e tregut të punës



... Vijon

Pjesëmarrja e punëtorëve të moshuar në fuqinë punëtore është rritur ndjeshëm në të gjithë vendet e OECD-së. Shkalla e punësimit të moshave 55-64 vjeç në vendet e OECD-së ka arritur në 64% të tyre, në tremujorin e dytë të 2023, pothuajse 8 pikë përqindjeje më e lartë se një dekadë më parë. Megjithatë, shumë punëtorë të moshuar ende punojnë për të përditësuar aftësitë e tyre, si edhe për të pasur akses në punë me cilësi të mire. Disa nga këta punonjës rrezikojnë të kenë një pension të pamjaftueshëm në pleqëri, për shkak të karrierave të shkurtra dhe të paqëndrueshme të punës.

Sekretari i Përgjithshëm i OECD-së, Mathias Cormann theksoi në prezantim të botimit “Një vështrim mbi pensionet, 2023” se ky publikim ofron të dhëna dhe analiza krahasuese mbi sistemet e pensioneve dhe reformat në të gjithë vendet e OECD-së, për të ndihmuar ato vende të sigurojnë që sistemet e pensioneve mbeten një burim i sigurt, i qëndrueshëm, efektiv dhe i drejtë i të ardhurave nga pensioni. “Vetëm reforma e pensioneve nuk mund të adresojë plotësisht ndikimin e plakjes së popullsisë dhe zgjatjen e jetëgjatësisë në qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve. Duke ofruar mbështetje për trajnim dhe duke siguruar kushte të shëndetshme pune, vendet mund të përmirësojnë perspektivat e punësimit të punëtorëve të moshuar. Kjo do të ndihmojë të sigurohet që sistemet e pensioneve të mbeten financiarisht të qëndrueshme, duke ofruar të ardhura të mira në pension”, theksoi Sekretari i Përgjithshëm i OECD-së.

Botim “Një vështrim mbi pensionet, 2023” vlerëson ndikimin e politikave të veçanta të pensioneve në vendet e OECD-së për punëtorët në punë të rrezikshme dhe të mundimshme, duke përfshirë ato që japin akses në pension të parakohshëm nëpërmjet skemave specifike të profesionit ose rregullave të veçanta brenda një skeme të përgjithshme pensioni. Parandalimi i problemeve shëndetësore dhe rikualifikimi për të larguar punëtorët nga punët e vështira përpara se shëndeti të përkeqësohet është thelbësor për ta.

Informacioni i plotë mbi botimin e OECD gjendet në linkun:

<https://www.oecd.org/newsroom/improving-opportunities-and-working-conditions-for-older-workers-can-bolster-pension-system-sustainability-and-address-labour-market-shortages.htm>

BULLGARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave zyrtare tremujore të publikuara në faqen e internetit të Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, tregu vendas i sigurimeve realizoi për periudhën janar-shtator 2023 një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 3.29 miliardë BGN ose rreth 1.68 miliardë euro. Kjo shifër është 24.21% më shumë se realizimi i primeve në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit e Jetës u rrit me 20.63% duke arritur në 533.99 milionë BGN, ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit e Jo-Jetës u rrit me 24.93% duke arritur në 2.75 miliardë BGN.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u rrit me 42.20% në terma vjetore, duke arritur në 1.49 miliardë BGN ose rreth 764.35 milionë euro. Kjo rritje lidhet më shumë me rritjen pothuajse 50% të sigurimeve të Jo-Jetës që arritën në 1.28 miliardë BGN.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave për 9-mujorin 2023, të publikuara nga Banka Kombëtare Çeke, tregu çek i sigurimeve e mbylli tremujorin e tretë të vitit 2023 me vëllimin e primeve të shkruara bruto me vlerë 160.9 miliardë CZK ose rreth 6.6 miliardë euro. Kjo shifër tregon një rritje me 6.1% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Dëmet e paguara nga siguruesit vendas arritën në 81.4 miliardë CZK, ose rreth 3.3 miliardë euro, shifër që tregon një rënie me 7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara, prej 56.8 miliardë CZK lidhet me policat e sigurimit të Jo-Jetës.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas publikimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut, gjatë vitit 2023, vlera e primeve të paguara nga pronarët e automjeteve arriti në rreth 87 milionë euro për sigurimin e përgjegjësisë motorike. Nga kjo shumë, 21 milionë euro janë paguar për policat e sigurimit të Kartonit Jeshil. Numri i policave të sigurimit të automjeteve arriti në mbi 697,700 polica për automjete, duke përfshirë këtu mjete pasagjerësh dhe mallrash, autobusë, motoçikleta, traktorë, rimorkio dhe automjete speciale. Sipas të dhënave paraprake të Byrosë Kombëtare të Sigurimeve, numri total i automjeteve me polica të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë motorike në vitin 2023 u rrit me 5% krahasuar me vitin e kaluar.

Sipas të dhënave statistikore, një në tre automjete të siguruar kishte edhe policë sigurimi të Karton Jeshil.

Sipas Byrosë Kombëtare të Sigurimeve, në vitin 2023 qytetarë, kompani dhe institucione kanë blerë gjithsej 958,528 polica sigurimi automjetesh brenda dhe jashtë vendit. Shuma totale e investuar në sigurimin e përgjegjësisë motorike arriti në 5.33 miliardë denarë ose 86.75 milionë euro, që tregon rritje prej 6.5%.

SERBI

www.xprimm.com

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për 9-mujorin e vitin 2023 në tregun e sigurimeve të Serbisë arriti në vlerën e 115.61 miliardë RSD ose rreth 986.47 milionë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 16.32% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën në 94.19 miliardë RSD, duke shënuar një rritje me 18.97%. Ndërsa primet e sigurimit të Jetës arritën në 21.42 miliardë RSD, duke u rritur me 5.94% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vlera e dëmeve të paguara u rrit me 16.54% në terma vjetore, duke arritur në 52.48 miliardë RSD ose rreth 478 milionë euro. Pjesën më të madhe të dëmeve të paguara, me rreth 38 miliardë RSD, e zinin dëmet e lidhura me sigurimet e Jo-Jetës, ndërsa pjesa tjetër prej 14.48 miliardë RSD ishin pagesa që lidheshin me sigurimet e Jetës.

Në fund të shtatorit 2023, në vend operonin 16 kompani sigurimesh.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas statistikave për 9-mujorin 2023, të publikuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë, tregu sllovak i sigurimeve arriti në 1.46 miliardë euro, me rritje 1.46% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e shkruara bruto për segmentin e sigurimit të Jetës ranë me 4.63% në terma vjetore, duke arritur në 559.06 milionë euro. Ndërsa primet e sigurimit të Jo-Jetës shënuan një rritje me 5.64% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, duke arritur në 900.92 milionë euro. Pjesën më të madhe në vëllimin total të primeve e zënë ato të sigurimit të Jo-Jetës, me 61.71% të totalit.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas u ul me 16.26% në terma vjetorë duke arritur në 709.62 milionë euro. Pjesa më e madhe e tyre, prej 400.34 milionë euro ishte e lidhur me klasat e Jo-Jetës, ndërsa 309.28 milionë euro lidhen me dëmshpërblimet e Jetës.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të tregut nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit sllovenë në nëntëmujorin e vitit 2023 u rrit 9.89% në terma vjetore, duke arritur në 2.35 miliardë euro. Primet e sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 11.36% në terma vjetore, duke arritur në 1.74 miliardë euro. Ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës u rrit me 5.92% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 609.68 milionë euro.

Për të njëjtën periudhë, vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit u rrit me 16.99% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.55 miliardë euro.

Shifrat e publikuara nga shoqata e sigurimeve në vend përfshijnë të dhënat nga 18 sigurues aktivë.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas risiguruesit global Munich Re, seria e tërmeteve në Turqinë juglindore dhe Siri në shkurt 2023 ishin fatkeqësia natyrore më shkatërruese e vitit të kaluar. Lëkundja e tërmetit me magnitudë 7.8 ishte më e forta në Turqi përgjatë dekadës së fundit. Shumë njerëz humbën jetën, ndërtesa të panumërta u shembën, si edhe pati dëme të konsiderueshme në infrastrukturë.

Përlogaritja e dëmeve prej rreth 50 miliardë dollarë, ishte gjithashtu fatkeqësia natyrore më e kushtueshme e vitit. Pavarësisht se sigurimi nga tërmeti është i detyrueshëm për ndërtesat e banimit në Turqi (*Turkish Catastrophe Insurance Pool, TCIP*), humbjet e mbuluar nga sigurimet arritën në vetëm 5.5 miliardë dollarë.



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al